




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në bazë të Rregullores 04/2017 Mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve shpall këtë:

Thirrje publike për mbështetje financiare të OJQ-ve jo-qeveritare të komuniteteve

1. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare që vijnë nga radhët e komuniteteve jo shumicë (Rom, Ashkali dhe Egjiptian) të Regjistruar në Republikën e Kosovës, që veprojnë në komunën e Gjakovës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e komuniteteve pakice, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në **Planin Lokal të Veprimin për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën Gjakovës 2024-2026** dhe Planin Punese të zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthimi 2026, po ashtu kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.

2. Të gjitha OJQ-të e regjistruan regjistrin e organizatave jo qeveritare të Republikës së Kosovës të komuniteteve të cilat veprojnë në komunën e Gjakovës mund të aplikojnë në këtë thirrje

- 2.1. Projekte të cilat kontribuojnë në fushat e përcaktuara në Planin Lokal të Veprimin për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2024-2026 siç janë arsimi, shëndetësia dhe mirëqenia sociale, punësimi, banimi, antidikriminimi dhe kultura dhe mediat.
- 2.2. Organizimi i punëtorive/trajnimeve për të rinjtë dhe gratë e komuniteteve, në ngritjen e kapaciteteve dhe bazuar në kërkesat e tyre dhe tregun e punës në Komunën Gjakovës.
- 2.3. Aktivitetet që synojnë adresimin e problematikave specifike me prioritet në arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale.
3. Vlera Totale e planifikuar për këtë thirrje është 10.000 €
4. Për OJQ-të që aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të aplikojnë për një projekt është 500.00€ deri në 10.000 €
5. Aplikantët dhe partnerët potencial për pjesën tjetër të kostove mund të sigurojnë bashkëfinancim nga donatorët dhe burimet tjera publike apo vetanake.
6. Afati për dorëzimin e propozimeve është jo me pak se 15 ditë punë. Duke filluar nga data **15.07.2026 dhe përfundon me datën 04.08.2026**
7. OJQ-të mund të aplikojnë më së shumti me dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë në partneritet në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.
8. Periudha e zbatimit të projekteve është brenda vitit 2026.
9. OJQ-të po ashtu duhet të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.
10. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

11. Të drejtë aplikimi për projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrat e organizatave jo qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike, (të prezantohet certifikata e numrit fiskal, certifikata e regjistrimit dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar).

11.Së bashku me aplikacionin, OJQ-të janë të obliguara të paraqesin dëshmi të Vërtetimit Tatimor të ATK-së.

12.Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me Udhëzimet për Aplikantët janë në dispozicion në faqen e internetit Komuna e Gjakovës/Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (kk.rks-gov.net/gjakove/).

13.Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht në adresën :Rr. UÇK-së p.n.50.000 Gjakovë, Republika e Kosovës/Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

14.Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha, mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

15.Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

16.OJQ-të të cilat kanë qenë përfituese të subvencioneve gjatë vitit 2026 nga komuna e Gjakovës nuk mund të aplikojnë në këtë thirrje.

17.Të gjitha çështjet tjera që lidhen me thirrjen publike të sqarohen në zyrën e ZKKK-së.